



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 274/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Kimete Gashi - Kryetar, znj. Nita Bejta- Anëtare, z. Agon Ramadani – Anëtarë, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Anetare, , z. Vedat Poterqoi – Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Haxha Kom” - Vushtrri, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: “Ndertimi i rrugës Ali Zeneli në qytetin e Mitrovicës” me nr. prokurimi:642-22-6299-5-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Mitrovicës se Jugut , më datën: 09.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “ Haxha Kom” – Vushtrri, kundër njoftimit për kontrate, lidhur me aktivitetin të prokurimit: “Ndertimi i rrugës Ali Zeneli në qytetin e Mitrovicës” me nr. prokurimi:642-22-6299-5-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Mitrovicës se Jugut

II. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues lidhur me aktivitetit të prokurimit : “Ndertimi i rrugës Ali Zeneli në qytetin e Mitrovicës” me nr. prokurimi:642-22-6299-5-1-1 te bëjë përmirësimet e nevojshme për korrigjimin e njoftimit për kontrate.

III. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e OE ankues “Haxha Kom” – Vushtri aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 18.07.2022, “Haxha Kom” – Vushtrri ka parashtruar ankesë me nr: 274/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i rrugës Ali Zeneli në qytetin e Mitrovicës” me nr. prokurimi:642-22-6299-5-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna e Mitrovicës se Jugut.

OE ankues në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 1,7,27,69, dhe 71 të LPP-së si dhe nenet 18.9 dhe 26.4 të RrUOPP-se.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.07. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01.08.2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

Përgjigje ne pretendimin Ankimor

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Haxha Kom ka parashtruar anekese ne OSHP, ne fazën e kriterëve, i cili pretendon se AK-ja, ne dosje te tenderit ka vendosur kërkesa diskriminuëse.

Eksperti shqyrtues në mendimin përfundimtar i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa njoftimi për kontratë i datës. 30.06.2022, të anulohet dhe të obligohet AK-ja, që të veproj konfoim nenit 53.7 të LPP-se duke bërë përmirësimet e nevojshme .

Organi Shqyrtues i prokurimit me datë 01.08.2022 ka njoftuar AK dhe OE ankues lidhur me raportin e ekspertit –

Operatori ekonomik ankues “Haxha Kom” - Vushtrri me datën 01 Gusht 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së , ndërsa AK me datë 01.08.2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca kryesore për shqyrtimin e lëndës është mbajtur me datën: 09.09.2022 ne praninë e palëve, ku janë dëgjuar edhe njëherë pretendimet e palëve , janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Marrë këtë parasysh, PSH mbështetet ne ekspertizën se ekspertit shqyrtues se ankesa e OE ankuese aprovohet dhe te obligohet AK te beje përmirësimet e nevojshme të kërkesave në FDT.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli Shqyrtues sa i përket pretendimit të parë, lidhur me këtë pretendim te OE ankues se lista e te punësuarve ne kompani min. 60 punëtor ku 60% duhet te ketë Lideri, duke respektuar konsistencën e vendimeve, konsideron se AK ka te drejte caktimin e përqindjen se punëtoreve dhe atë bazuar ne nenin 27.4 te RrOUPP-se dhe neneve 68 dhe 69 te LPP-se

Paneli Shqyrtues vlerëson, duke respektuar konsistencën e vendimeve, se kërkesa qe OE-se te ofrojnë si dëshmi qe punëtorët te jene te regjistruar ne ATK te lejohet për punëtorët si dëshmi – informatë mbi fuqinë punëtore te OE, ndërsa për inxhinieret e fushave te ndryshme specifike, Paneli Shqyrtues e konsideron se dëshmia nga ATK-ja duhet te hiqet ashtu qe te lejohet qe OE-te te kenë mundësi te sigurojnë angazhim te inxhinierëve edhe përmes marrëveshjeve si dhe para kontratave.

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues ku pretendon se kërkesa e në FDT që kërkohet lista e projekteve të realizuar për 3 (tri) vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, të kryera në lëmin e ndriqimit publik dhe punëve të ngjashme. Të ketë të paktën dy projekte te perfundura me ndriqim Publik me vlere mbi 300,000 €(Secila).Paneli Shqyrtues lidhur me këtë kërkesë të parashtruar nga AK vlerëson se kufizohet pjesëmarrja e OE –ve në këtë aktivitet të prokurimit për faktin se aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me asfaltimin e rrugës ndërsa ndriqimi i rrugës mund të nënkontraktohet nga Operatori Ekonomik ofertues i cili nuk ka zhvilluar ndonjë kontratë drejtëpërdrejtë lidhur me ndriqimin. Meqenëse pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe se aktiviteti i prokurimit është asfaltimi i rrugës dhe ndriqimi i rrugës mund të bëhet edhe nga nënkontraktor nuk është e nevojshme të kërkohen nga AK : Certifikata ENEC të cilësisë për ndriqim LED (pika 14 e FDT-së), Autorizim nga prodhuesi për trupat ndriques të ofruar në ofertë duhet të jetë EU (pika 15 e FDT-së) dhe Operatori Ekonomik duhet të prezentoj garancionin nga prodhuesi min 5 vite për trupa ndriques LED pas pranimit teknik (pika 16 e FDT-së).

Paneli shqyrtues, në vazhdim sqaron se OE ankues tek pretendimet ankimore lidhur me pajisjet e kerkuara ne dosje te tenderit, ku kerkon qe disa pajisje te hiqen në tërësi si kërkesa, për të cilat

eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës ka rekomanduar që të largohen nga FDT- për shkak se AK nuk ka arritur të argumentoj se pse kërkohet kjo pajisje e cila përdoret për ndërtime të larta - kërkesa si ajo në pikën 17 .Nje Pomp per hudhjen e betonitint ne veper 36m , pastaj kërkesat tjera sipas renditjes : në pikën 22. Pese Shlipera për bartjen e zhavorit 22 -24m³ , kërkesa në pikën 21.Dhjetë kamiona me kapacitet 15-20cm³ n ndersa ne kerkesen nr. 20 dy Kamiona me kapacitet min 10m³ , kërkesa me nr.23 Nje Skip 8t, për të gjitha këto pretendime lidhur me pajisjet teknike AK është pajtuar me mendimin e ekspertit që duhet të largohen disa nga pajisjet teknike dhe po ashtu të zvogëlohet nr i tyre.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
zgj.Kimete Gashi

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “ KK- Mitrovicë”,
- 1x1 OE - “Haxha Kom”SH.P.K.– Vushtri,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.